



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

V E N D I M

Nr. 47, Datë 12/05/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 144, datë 11.11.2019, e z. Th.K., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”, nga ana e Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Z. Th.K. ka punuar në pozicionin magazinier pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës (QPN) Fier, të Albpetrol sh.a. Si pasojë e ristrukturimit organizativ të Shoqërisë Albpetrol, ankuesi është përfshirë në pushim kolektiv dhe kontrata e tij individuale e punës është zgjidhur nga ana e kësaj shoqërie. Nëpërmjet shkresës nr. 6766, datë 27.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., ankuesi është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të pushimit kolektiv, ndërkohë që me Vendimin nr. 1157, datë 15.11.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Z. Th.K.. Për sa më sipër, ankuesi pretendon se ai është larguar nga puna për shkak të bindjes së tij politike, pasi ai është anëtar i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim³.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

¹ Referuar vërtetimit të lëshuar nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, Dega Fier.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar Vërtetimit të lëshuar nga LSI, Dega Fier.

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 144, datë 11.11.2019, e Z. Th.K., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a., me shkresën nr. 1712/1, datë 19.11.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Kopje e kontratës së punës së ankuesit me Albpetrol sh.a. si dhe Urdhërat e emërimit të tij, në të gjitha pozicionet e punës, që ai ka mbajtur pranë Albpetrol sh.a.;
 - Kopje e librezës së punës së ankuesit;
 - Informacion, nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore gjatë periudhës, që ka punuar pranë Albpetrol sh.a. Nëse po, të dërgohen bashkëlidhur kopje të akteve përkatëse administrative;
 - Vlerësime për punën e kryer nga ankuesi ndër vite pranë Albpetrol sh.a., si dhe kopje të vlerësimeve të punës për të gjithë punonjësit që kanë punuar në të njëjtin pozicion pune me Z. Th.K., pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës (QPN) Fier;
 - Kopje e praktikës së përfshirjes së ankuesit në pushim kolektiv, ku të përfshihen:
 - Njoftimi i Albpetrol sh.a. drejtuar ankuesit, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
 - Vendimi i Albpetrol sh.a. drejtuar ankuesit, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
 - Proçesverbalet e vlerësimit me pikëzim për ankuesit, si dhe të gjithë punonjësit, që kanë punuar në pozicionin e ankuesit pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës (QPN) Fier;
 - Dokumentacioni i dosjes personale, për të gjithë punonjësit e sipërpërmendur, përfshirë ankuesit.
 - Informacion nëse ankuesi e ka ankimuar Vendimin nr. 1157, datë 15.11.2018, e Administratorit, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, pranë Komisionit të Vlerësimit të Ankesave, të ngritur nga Albpetrol sh.a. Nëse po, të dërgohet kopje e ankesës së tij dhe shkresës zyrtare të dërguar nga shoqëria në adresë të ankuesit.
 - Numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës së Prodhimit të Naftës (QPN) Fier, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna;
 - Numri i përgjithshëm i magazinierëve, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës (QPN) Fier;
 - Kopje e strukturës së mëparëshme dhe strukturës aktuale të Qendrës së Prodhimit të Naftës (QPN) Fier.

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Me shkresën nr. 1712/2, datë 12.12.2019, Albpetrol sh.a. i dërgoi përgjigje Komisionerit. Sipas shkresës së sipërpërmendur, z. Th.K. ka qenë i punësuar pranë Qendrës së Prodhimit dhe Naftës Fier, qendër kjo në varësi të kësaj shoqërie, me detyrë “magazinier” në Sektorin VI-të në QPN Fier, deri në datën 15.11.2018, në të cilën i janë shkëputur marrëdhëniet e punës dhe ato financiare, vërtetuar kjo edhe me shënimin e kryer nga zyra e personelit, në librezën e punës së ankuesit.

Albpetrol sh.a. thekson faktin se, sikurse e ka bërë me dije edhe me parë KMD-në, në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, i miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018 të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria Albpetrol sh.a. është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye, ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv, duke njoftuar punonjësit që preken nga ky proces. Në Qendrën e prodhimit Fier, sipas strukturës së vjetër organike, ishte i përfshirë pozicioni “magazinier” në Sektorin VI-të, në QPN Fier. Në bazë të strukturës së re organizative të QPN Fier, të miratuar nga Administratori i Shoqërisë, pozicioni i punës “magazinier” në Sektorin VI-të është suprimuar (shkurtuar). Me shkresën nr. 6650, datë 27.07.2018, me lëndë “Vendimi nr. 463, datë 27.07.2018 “Për miratimin e listës së punonjësve të prekur nga ristrukturimi organizativ dhe reduktimi i fuqisë punëtore”, Administratori ka kryer procedurën përkatëse duke miratuar listën me nr. 6650/1, datë 27.07.2018 dhe listën nr. 6650/2, datë 27.07.2018, të përcjellë nga QPN Fier. Për sa më sipër, rezulton se përfshirja e z. Th.K., në pushimin kolektiv, lidhet me shkurtimin e pozicionit të tij të punës. Albpetrol sh.a. thekson faktin se ka ndjekur në mënyrë të rregullt procedurat ligjore të parashikuara në nenet 143 e 148, të Kodit të Punës, duke e njoftuar ankuesin, nëpërmjet shkresës nr. 6766, datë 27.07.2018, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Shkëputja e marrëdhënieve të punës është kryer me shkresën nr. 11376, datë 15.11.2018, e Administratorit të kësaj shoqërie. Në shkresë theksohet fakti se, instituti i pushimit kolektiv nga puna përbën një nga format e zgjidhjes së kontratës së punës dhe është parashikuar shprehimisht në Kodin e Punës. Pushimi Kolektiv, shpesh, diktohet nga transformimet e ndërmarrjeve, ose edhe nga ulja e aktivitetit të tyre. Në rastin konkret, Albpetrol sh.a. sqaron se zgjidhja e kontratës së punës me z. Th.K. ka ndodhur si pasojë e pushimit kolektiv, si pasojë e uljes së aktivitetit prodhues të shoqërisë dhe jo si pasojë e një pushimi individual, selektiv, apo diskriminues nga puna, siç pretendohet nga ankuesi. Procesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimit të fuqisë punëtore është një proces dinamik, që ka prekur punonjës të profesioneve, moshave dhe me vjetërsi pune të ndryshme.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike, të djathta, Albpetrol sh.a. sqaron se ky pretendim është i pabazuar pasi shoqëria nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë partiake të punonjësve të saj, por vetëm të dhëna personale bazë të punonjësve, për të cilët është marrë dhe miratimi i tyre me shkrim, sipas formularit përkatës, si dhe në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit në fuqi. Në asnjë praktikë apo shkresë të punëdhënësit nuk është përmendur përkatësia e ndonjë prej punonjësve. Në shkresë theksohet fakti se, pranë Albpetrol sh.a. janë paraqitur ankesa nga punonjës të prekur nga ristrukturimi, të cilët pretendojnë bindje të ndryshme politike, fakt i cili hedh poshtë pretendimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike. Albpetrol sh.a. shprehet se ankuesi ka barrën e provës të vërtetojë me prova shkresore që punëdhënësi ka qenë zyrtarisht në dijeni

të përkatësisë së bindjes politike të tij, pasi është logjike që të diskriminosh dikë duhet të kesh dijeni paraprakisht mbi bindjet e tij politike.

Ndër të tjera, Albpetrol sh.a. shprehet se nuk disponon kopje të librezës së punës së ankuesit dhe se në dosjen e tij personale nuk rezultojnë masa disiplinore në ngarkim të tij. Lidhur me vlerësimet e punës së ankuesit, Albpetrol sh.a. sqaron se nuk disponohen vlerësime pune, as në dosjen e tij personale dhe as në dosjet personale të punonjësve të tjerë të QPN Fier. Njëkohësisht, kjo shoqëri sqaron se nuk ekzistojnë Proçesverbale të Vlerësimit me Pikëzim, të mbajtura nga Komisioni i Vlerësimit dhe Pikëzimit, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me suprimim të vendit të punës.

Albpetrol sh.a. sqaron se nuk është në dijeni të faktit, mbi ankimimin e Vendimit nr. 1157, datë 15.11.2018, të kryer nga ankuesi, por edhe nëse do të rezultonte të kishte ankimim të depozituar, Administratori e ka shprehur vullnetin e tij pasi ka miratuar listën përkatëse të punonjësve, që preken nga pushimi kolektiv me vendimet nr. 6650/1, datë 27.07.2018 dhe listën nr. 6650/2, datë 27.07.2018, të përcjellë nga QPN Fier.

Bashkelidhur shkresës së Albpetrol sh.a. është dërguar dokumentacioni i kërkuar nga KMD.

A. Në vijim të ndjekjes së proçedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 11.02.2020, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesi Th.K. dhe përfaqësuesja e Albpetrol sh.a., e cila depozitoi Autorizimin e datës 11.02.2020, lëshuar nga Administratori i Albpetrol sh.a.

Ankuesi parashtroi në seancë pretendimet e tij, të cilat konsistojnë në diskriminimin e tij për shkak të bindjeve politike, duke theksuar faktin se është përfshirë në pushimin kolektiv pasi është anëtar i LSI-së. Në seancë, ankuesi shtoi si shkak diskriminimi etninë, pasi i përket komunitetit vllah të Shqipërisë, si dhe shkakun e diskriminimit se ai mban pozicionin e koordinatorit ndërmjet Sindikatës Autonome të Naftës (S.A.N.) dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Transportit të Shqipërisë, që prej vitit 2014.

Ai u shpreh se ka punuar në disa pozicione pune pranë Albpetrol sh.a., por pozicioni i fundit i punës ishte magazinier pranë QPN Patos. Z. Th.K. u shpreh se shume ish punonjës të tjerë janë rikthyer në punë, ndërkohë që ai nuk është kthyer. I pyetur nëse ai kishte paraqitur kërkesë me shkrim për ripunësim pranë Albpetrol sh.a., pas largimit nga Albpetrol sh.a., ankuesi u përgjigj që nuk e kishte bërë një gjë të tillë. Ai u shpreh se ka qenë magazinier në Sektorin 6, të QPN Fier dhe vendi i tij i punës është shkurtuar, por pavarësisht kësaj ai s' duhej të përfshihej në pushim kolektiv, pasi kishte kualifikime në këtë fushë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

Përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. u shpreh se përfshirja e ankuesit në pushim kolektiv nuk kishte të bënte me bindjen e tij politike apo me shkaqet e tjera të përmendura me sipër. Pozicioni i tij i punës është shkurtuar dhe në këto kushte ai nuk i është nënshtruar vlerësimit më pikëzim. Përfaqësuesja sqaroi se sikurse ankuesi, janë larguar nga puna në kuadër të ristrukturimit të Albpetrol sh.a. edhe shumë punonjës të tjerë, me vjetërsi të madhe në punë dhe me kualifikime të shumta në profesion. Albpetrol nuk ka dijeni mbi bindjet politike të ankuesit, pasi bindja politike nuk është kriter punësimi

pranë kësaj shoqërie. Njëkohësisht, në dosjen personale të këtij punonjësi nuk rezultojn të administrohet asnjë dokument që vërteton përkatësinë politike të tij.

A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Z. Th.K. ka punuar pranë Albpetrol sh.a. që prej vitit 2014, duke mbajtur fillimisht pozicionin e operatorit të prodhimit, e në vijim ka mbajtur pozicionin e magazinierit, pranë QNP Patos, detyrë, të cilën e ka vazhduar deri në datën 15.11.2018. Në këtë datë, marrëdhëniet e punës së ankuesit me Albpetrol sh.a. janë ndërprerë pasi pozicioni i tij i punës është suprimuar, në kuadër të ristrukturimit të përgjithshëm të Albpetrol sh.a.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës rezultojn se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a. është duke zbatuar një proces ristrukturimi, si rrjedhim i së cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezultojn se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1.Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë *“Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”* parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njësisë të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.me përbërje 3 (tre) Qendra të

Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur, fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë të të përcaktoshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t'u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t'i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t'i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të QPN Fier, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë është reduktuar, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve pranë kësaj Qendre. Referuar

strukturës organike paraardhëse dhe strukturës aktuale të QPN Fier Sektori Patos, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve që i është nënshtruar pushimit kolektiv është 96 punonjës. Në QNP Fier ka patur gjithashtu shkurtime edhe në sektorë të tjerë, si në Sektorin Ballsh-Hekal dhe Cakran Mollaj ku 57 punonjës të tjerë i janë nënshtruar pushimit kolektiv.

Për këtë arsye, mbështetur në nenin 143 dhe 148 të Kodit të Punës, të gjithë punonjësit që i janë nënshtruar pushimit kolektiv, janë njoftuar për ndërprerje të marrëdhënies së punës me shoqërinë. Ankuesi është njoftuar me shkresën nr. 6766, datë 27.07.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës. Në vijim, z. Th.K. i është dërguar Vendimi nr. 1157, datë 15.11.2018, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare dhe ato të punës.

Sikurse u përmend edhe më sipër, rezulton se 96 punonjës të Sektorit Patos, të QNP Fier i janë nënshtruar pushimit kolektiv, ndër të cilët edhe ankuesi, i cila punonte në pozicionin e magazinierit. Ky pozicion u shkurtua/suprimua dhe për këtë arsye ankuesi nuk iu nënshtrua vlerësimit me pikëzim. Në referencë të shkresës nr. 5537, datë 02.07.2018, së Albpetrol sh.a., rezulton se në çdo Komision Vlerësimi të ngritur pranë çdo qendre prodhimi apo shërbimi, në varësi të Albpetrol sh.a., bën pjesë në cilësinë e anëtarit edhe një përfaqësues i Sindikatës së Naftëtarëve, e cila është përfaqësuese e punonjësve të Albpetrol sh.a. Kjo shërben si një garanci për të gjitha veprimet e kryera nga Komisionet përkatëse, pasi përfaqësuesit e Sindikatës mbrojnë interesat e punonjësve të Albpetrol sh.a.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ai nuk është ripunësuar sërish pranë Albpetrol sh.a., ndërkohë që shumë ish-punonjës të larguar me anë të pushimit kolektiv janë ri-punësuar, Komisioneri gjykon se në kushtet kur ankuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë me shkrim pranë kësaj shoqërie, ku të kërkohej ripunësim, nuk mund të kemi një pretendim të mbështetur nga ana ligjore. Albpetrol sh.a. ka përcjellë në cilësi prove të vetmen kërkesë⁵ që z. Th.K. ka përcjellë pranë kësaj shoqërie nëpërmjet së cilës kërkon vjetërsinë në punë, e cila i është dhënë në vijim nëpërmjet shkresës nr. 1232, datë 14.12.2018. Albpetrol nuk ka dërguar informacion të mëtjshëm, lidhur me emrat e personave, për të cilët ankuesi pretendon se janë ri-punësuar, në vijim të pushimit kolektiv.

Pretendimi për diskriminim për bindje politike etj. i z. Th.K. konsiston në largimin e tij nga puna për shkak të pushimit kolektiv, fakt që Komisioneri gjykon se nuk është i mbështetur, në kushtet kur nga QNP Fier, Sektori Patos janë larguar 96 punonjës si pasojë e ristrukturimit të Albpetrol sh.a. dhe pozicioni i tij i punës është suprimuar.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një

⁵ Kërkesë e datës 08.11.2018, e z. Th.K. ku kërkohet vjetërsia në punë, përkatësisht 4 vjet, 8 muaj, 14 dite.

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të z. Th.K., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga ana e Albpetrol sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha - Punesim
Shkak – bindja politike